

Sinjalizime

Ekskluzive | Ky është i dyshuari që iu gjetën AK-47 e pistoletë në bagazhin e BMW-së në Ferizaj – sekuestrohen 181 fishekë



Sinjali.com

14 Gusht 2026 08:17



Sinjali ka mësuar identitetin e personit të arrestuar pas një bastisjeje të zhvilluar të enjten në fshatin Manastirc të Ferizajt, ku Policia gjeti dhe sekuestroi dy armë dhe një sasi të konsiderueshme municioni.

Burimet e Sinjalit bëjnë të ditur se i dyshuari është Flamur Haxhidema rreth 35 vjeç, i cili është ndaluar për 48 orë me vendim të Prokurorisë.

Aksioni është zhvilluar më 13 gusht, pasi Njësitë i Hetimeve ka zbatuar një urdhëresë të Gjykatës Themelore në Ferizaj për kontrollin e shtëpisë dhe objekteve përcjellëse të të dyshuarit.

Gjatë bastisjes, në garazhin e shtëpisë, përkatësisht në bagazhin e BMW-së së zezë në pronësi të Haxhidemës, Policia ka gjetur dhe sekuestruar një AK-47, tre karikatorë dhe 139 fishekë.



Lexo edhe

Bastisje në Ferizaj: Policia gjen kallashnikov e pistoletë në bagazhin e BMW-së – sekuestrohen 181 fishekë



Në të njëjtin kontroll është gjetur edhe një pistoletë “Zigana”, me dy karikatorë dhe 42 fishekë të kalibrit 9×19 mm.

Në total janë sekuestruar dy armë, pesë karikatorë dhe 181 fishekë.

Për rastin është njoftuar Prokuroria Themelore në Ferizaj dhe, me autorizim të Prokurorit kujdestar, është iniciuar rasti për “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”.

Haxhidema është intervistuar në praninë e avokatit mbrojtës dhe më pas është ndaluar për 48 orë, ndërsa rasti do të procedohet në Prokurori me procedurë të shpejtë.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Armë


Ferizaj

Fishekë

Policia

sekuestrim

Të tjera:



Gjendet 15-vjeçarja nga Peja që ishte raportuar e zhdukur – Policia e lokalizon pas kërkimev...

Sinjalizime



Policia shpëton një 21-vjeçare në Podujevë – tentoi të hidhej nga kati i tretë i një objekti në...

Sinjalizime



Policia e Kosovës ndan mbi 45 mijë euro për renovimin e qendrave të ndalimit në Gjakovë

Siguri



Pejë: Policia shqipton masa ndaj 171 motoçiklistëve për kundërvajtje në...

Siguri



Ekskluzive | Këta janë dy të dyshuarit për sulmin ndaj policëve në Vushtrri – gjithçka nisi...

Sinjalizime



Të shtëna në Podujevë, Policia intervenon në Bradash – 25-vjeçari pranon se shkrepë, i...

Sinjalizime



Krismat alarmojnë Policinë në një dasmë në Burojë të Skenderajt – pronari pranon se shti...

Sinjalizime



Ekskluzive| Rrahje në Letanc të Podujevës, kamerat zbardhin çfarë ndodhi – dy të rinj...

Sinjalizime

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitnes
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera